



Dokumenti i Sirakuzës

Mësimdhënia dhe Mësimi Online në Arsimin e Lartë gjatë COVID 19

Ne jemi më të fuqishëm se sa mendojmë! Me një kosto të ulët! Sami BASHA

Akademia Pas Korona I + II / 2020

Në përfundim të dy takimeve ndërkombëtare së bashku, (14 Prill; 22 Maj 2020), nga mbi 100 universitete në më shumë se 50 vende, mbi 100 akademikë u takuan së bashku për të diskutuar problemet akademike pas koronës. Universiteti Amerikan i Sicilisë (AUS) i cili organizoi këtë ngjarje ndihet krenar dhe i lumtur që përcjell rekomandimet dhe rezultatet përfundimtare të kësaj nisme ndërkombëtare nën titullin: Dokumenti Sirakuzës mbi "Mësimdhënien dhe Mësimin Online në Arsimin e Lartë gjatë COVID 19".

(1) Universiteti Amerikan i Sicilisë mirëpriti iniciativën e mbikqyrrur nga anëtarët e bordit këshillues / në bashkëpunim me të gjithë partnerët globalë të AUS. Iniciativa frymëzohet nga vizioni dhe misioni i AUS duke nxitur ndërkombëtarizimin / për të pasuruar akademitë. Takimi i parë "Academia post Corona" i mbajtur në distancë më 14 Prill, 2020, u organizua për të qenë një takim dinamik ndërkombëtar me shkencëtarë të fushës, për të ofruar rekomandime inovative dhe propozime për zgjidhje konkrete. Edicioni i dytë, gjithashtu u zhvillua në distancë më 22 Maj 2020, si një përpjekje për t'u dhënë pjesëmarrësve një zë dhe / mundësi për të dhënë shembuj të zgjidhjeve efektive dhe praktike për të vazhduar më tej diskutimin e parë. Ne u jemi shumë mirënjohës të gjithë atyre që morën pjesë në këtë diskutim, por një falënderim i veçantë i shkon / Prof. Gregory Light, ish drejtor i Qendrës Searle për progresin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në Universitetin Northwestern dhe Dr. Rebecca Hopkins, Dekan i Asociuar i Mbështetjes dhe Tranzicionit në Kolegjin Teknik Perëndimor - të dy pjesëmarrës në bordin tonë këshillues / duke bashkëpunuar ngushtë me Prof. Sami Basha, President i Universitetit Amerikan të Sicilisë për të realizuar këto aktivitete dhe këtë dokument të rëndësishëm.

(2) Pjesëmarrësit u interesuan për këtë takim të rëndësishëm në kërkim të një dialogu cilësor për rolin potencial që ne të gjithë kemi në Arsimin e Lartë pas COVID. Kjo gjë shërbeu si vendimtare për rishikimin e roleve, për të shqyrtuar sesi mënyra e jetës do të ndryshojë dhe ndikojë në mësimdhënien dhe mësimnxënien virtuale, si dhe në diskutimin për ndikimin e kësaj pandemie në sistemin e arsimit të lartë në të gjithë botën. Gjithashtu, kjo rezultoi të ishte një përvojë e shkëlqyer mësimi me folës të njohur që frymëzuan diskutimet e ndryshme. Të gjithë pjesëmarrësit sollën ekspertizën, drejtimin, vizionin, njohurinë dhe motivimin e tyre në takimet në vijim për të nxitur metodat inovative në të ardhmen e mësimdhënies dhe mesimit online.

Parathënie

Nga këto takime, ne jemi të lumtur të ndajmë këndvështrimin tonë mbi praktikat efektive që duhet të formohen për një përvojë të suksesshme dhe pasuruese në një mjedis mësimor dhe mësimdhënie në internet. Me rëndësi, duhet theksuar fakti se mbyllja ka rritur nivelin e pabarazisë në arsim, veçanërisht për ata që dhe më parë hasnin vështirësi në vendet në zhvillim, ku mungojnë mjetet dhe burimet e nevojshme. Një numër i lartë i studentëve nuk kanë një vend të duhur studimi dhe një përqindje e madhe e tyre jetojnë në mjedise të mbingarkuara me persona të tjerë, pa disponueshmërinë e kompjuterave dhe pajisjeve elektronike të përshtatshme. Kështu, nëse ne i lëmë pas dore këto grupe, Institucionet e Arsimit të Lartë shëndrrohen në spitale që trajtojnë persona të shëndetshëm duke i lënë pacientët jashtë.



Më tej, Institucionet e Arsimit të Lartë do të vazhdojnë të përjetësojnë pabarazinë sistematike duke zgjeruar dallimet dhe kufizuar lëvizshmërinë sociale.

Për më tepër, mes akademikëve, shfaqen përqindje të larta me aftësi jo të mira mësimore për platformat në internet; për rrjedhojë, në përputhje me rrethanat, teknologjia përdoret për të dhënë më shumë përmbajtje, pa hartuar një përvojë të qëllimshme mësimdhënie që teknologjia ofron. Prandaj, duhet gjetur një ekuilibër dhe përdorim i qëllimshëm të teknologjisë për të vazhduar dialogun dhe përmirësuar praktikën tonë. Si përfundim, ne mendojmë se ajo që po ndodh në të gjithë botën nuk ka qenë një përvojë e strukturuar mirë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në internet, por përkundrazi një ndërhyrje emergjente derisa jeta akademike / të kthehet në normalitet. Shumë universitete ne pararoje kanë shënuar një sukses të madh, ndërsa të tjerët ende kanë vështirësi dhe hasin probleme në lidhje me këtë ndryshim të papritur, në përputhje me rrethanat; në vijim, shpresojmë që kjo periudhë tranzicioni do t'u japë me shumë mundësi universiteteve për të rishikuar kurrikulën dhe strukturat e vlerësimit, ofertat e tyre akademike dhe pengesat që mund të lehtësohen për studentët.

Në 10 pikat e mëposhtme përmblihen rezultatet e dy takimeve. Ne mendojmë se për të pasur mësimdhënie dhe mësim të suksesshëm në internet, duhet të ketë role dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara nga palët kryesore të interesuara për procesin arsimor (vendimmarrësit, Institucionet e Arsimit të Lartë, Fakultetet, studentët dhe familjet):

(1) Ne e konsiderojmë këtë si një kohë **zbulimesh** të reja për ne, si fakultetet dhe studentët tanë me aftësitë e tyre për të lundruar në botën e teknologjisë. Ata mund të na befasojnë me aftësitë, cilësitë dhe kompetencat e tyre. Për ta bërë këtë të mundur, duhet të vendosim një dialog të sinqertë me të gjithë studentët, si formë e rëndësishme e marrëdhënies arsimore, duke krijuar një mjedis të shëndetshëm për të siguruar më shumë mirëbesim. Studentët janë partnerë aktivë – për t'u përfshirë dhe ftuar me reagimet e tyre për të ndihmuar në përmirësimin e seancave në internet. Studentët shfaqin njohuri për nevojat e tyre të studimit dhe udhëzimet në internet, njëherazi, seancat duhet të jenë të personalizuar dhe intuitive.

(2) Ne duhet të implementojmë mësimdhënie dhe mësimnxënie në internet në mënyrë të tillë që të respektojnë nevojat e të gjithë studentëve dhe t'u sigurojë studentëve mundësi të barabarta arsimore. Një fokus i rëndësishëm u kushtohet atyre studentëve me programe arsimore individuale; por gjithashtu, në përgjithësi, udhëzime të diferencuara që janë me përgjegjësi kulturore dhe përfshijnë një angazhim të thellë studimi, mësimdhënie nga kolegët dhe projektim universal për arsimim gjithëpërfshirës.

(3) Ne besojmë tërësisht se **pedagogjia** duhet të udhëheqë teknologjinë dhe jo e kundërta. Fatkeqësisht, shumë nga kurset në internet shfaqen si një praktikë e ofrimit të përmbajtjes për t'u konsumuar, e cila nuk inkurajon angazhimin ose studimin.

(4) Një vlerësim i **lirisë akademike** do të ishte thelbësor për të gjitha vendet, për ta vendosur rëndësinë e ndjekjes së studentëve dhe fakulteteve, pavarësisht nga platforma mësimore, në mënyrë që fakultetet të fuqizohen dhe mbështeten për këtë tranzicion të shpejtë.

(5) Krijimi i një komuniteti në internet përbën **një akt kurajo** dhe besimi për përvetësimin të njohurive që ndikojnë në të ardhmen e të gjithë shoqërisë. Në përputhje me rrethanat, një veprim i ngjashëm i guximit duhet të ushtrohet nga qeveritë dhe kompanitë për të ndërtuar platforma dhe mjete cilësore me kosto të ulët për studentët dhe fakultetet, në mënyrë që të kapërcejnë pengesën ekonomike për mësimdhënie dhe mësimnxënie në internet.



- (6) Ne rekomandojmë që shërbimet e rëndësishme të vazhdojnë ose / të aktivizohen menjëherë, siç janë **këshillimi** dhe mbështetja psikologjike për studentët. Megjithatë, ne besojmë se disponueshmëria dhe prania e fakulteteve janë përbërësit kryesorë në suksesin e mësimit - veçanërisht për studentët që përballen me vështirësi të ndryshme.
- (7) Për më tepër, lind nevoja për të përgatitur një **udhëzues**, instruksione dhe trajnime për të gjitha fakultetet, me një përmbledhje praktike që mundëson informacion, sqarime dhe rekomandime kryesore për t'u marrë parasysh për përmirësimin e planeve ekzistuese dhe hartimin e planeve të reja gjatë periudhës së pandemisë dhe më tej.
- (8) Më poshtë, jepen disa shembuj që sjellin përvojat e pjesëmarrësve nga e gjithë bota: (a) Video të shkurtra ditore ose javore ose thirrje telefonike që mund t'i ndihmojnë studentët për të qenë më të angazhuar; (b) Nevojiten më shumë aftësi komunikuese dhe inkurajim krijues (fjalë dhe veprime) për të krijuar mësim tërheqës dhe efektiv duke siguruar mbështetje të plotë për të gjithë nxënësit; (c) Ne sugjerojmë që t'u kushtojmë përparësi mini-leksioneve / mësimëve dhe të mundësojmë më shumë kohë për ndërveprime midis studentëve; (d) Integrimi i kontekstit të shumëllojshëm (media, klipe TV, gazeta, harta, animacione dhe programe ndërvepruese të bazuara në internet, etj.) do të ndihmojnë në ruajtjen e angazhimit të studentëve dhe rritjen e entuziazmit për mësimin; (e) Mundësoni fleksibilitet për oraret e detyrave të shtëpisë; (f) Hulumtoni dhe ndiqni reagime aktive; (g) Ushtrimet për zgjidhjen e problemeve dhe detyrat e shtëpisë mund të nxisin motivimin e studentëve; si dhe (h) Mësimdhënia mbështetur në projekt.
- (9) Një numër çështjesh duhet të vihen në fokus dhe të përpunohen në seanca të specializuara: vlerësimi në internet / akreditimi i programeve në internet / kurse / punësimi / kurse praktike (veçanërisht në shkencat e aplikuara).
- (10) Ne besojmë se duhet të bëhet më shumë; megjithatë e konsiderojmë bashkarisht se mësimdhënia dhe mësimi në internet nuk duhet të trajtohen si një zëvendësues i përhershëm i mjedisit mësimor, ballë për ballë që plotëson nevojat e larmishme të studentëve si dhe ofron kompetenca me aftësi e shprehi të tjera.

Universiteti Amerikan i Siracusa



AUS - 2020

This document was translated from English into Albanian, corrected and reviewed by Polytechnic University of Tirana - Albania. Lecturers Romeo Teneqexhi and Fatmir Vrapci.